



Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët
Ministri i Shtetit për Diasporën
Republika e Shqipërisë



Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”
Republika e Kosovës

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

QENDRËS SË STUDIMEVE DHE
PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

DHE

UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”

PREAMBUL

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të cilët në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

Duke vlerësuar rëndësinë që ka bashkëpunimi me komunitetet shqiptare në diasporë në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen;

Për të evidentuar kontributin që ka komuniteti arbëresh në ruajtjen e gjuhës, kulturës, traditave dhe trashëgimisë kulturore shqiptare pa pasur një lidhje të vazhdueshme me vendin e origjinës;

Me dëshirën për të nxitur studimet dhe publikimet kërkimore shkencore dhe rritur cilësinë e tyre duke përfshirë akademikët dhe studiuesit e kësaj fushe kërkimore;

Me synimin për të përfaqësuar vlerat e kërkimit shkencor dhe bashkëveprimit dhe koordinimit të studimeve për kulturën dhe historinë e arbëreshëve;

Palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur Marrëveshja.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje është nxitja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për shkëmbimin e ekspertizës dhe studimeve e kërkimeve shkencore të përbashkëta për historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh.

Neni 2

Objekti i bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për:

- a. Kryerjen e studimeve të përbashkëta mbi historinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh;
- b. Organizimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjen në konferanca shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- c. Krijimin e grupeve të punës për aplikimin në projekte të përbashkëta në thirrjet e projekteve të publikuara nga donatorë të ndryshëm;
- d. Shkëmbime librash me fokus në studimet për komunitetin arbëresh;

Neni 3

Përgjegjësitë e palëve

Bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshje do të funksionojë si vijon:

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët do të realizojë:

- a. Përgatitjen për shtyp të studimeve të specializuara mbi historinë dhe kulturën arbëreshe;
- b. Botimin e studimeve të kryera për fushat e sipërpërmendura;

c. Realizimin e aktivitetave vjetore dhe konferencave shkencore me fokus komunitetin arbëresh;

Universiteti i Prishtinës do të realizojë:

- a. Ofrimin e ekspertizës me anë të anëtarëve të tij për realizimin e studimeve dhe publikimeve për arbëreshët duke siguruar cilësinë e kërkimit shkencor, si dhe mbështetjen studiuesve të rinj në këtë fushë;
- b. Koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj që janë të angazhuar pranë Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët; Vlerësimin, dokumentimin dhe përcjelljen e trashëgimisë akademike mbi komunitetin arbëresh të veprave të figurave më të spikatura në këtë fushë;

Neni 4

Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër të vlerësojnë bashkërisht zbatimin e marrëveshjes nëpërmjet hartimit dhe paraqitjes së një raporti periodik me shkrim, në përfundim të çdo viti kalendarik.
2. Raporti përban, krahas të dhënave për ecurinë e aktiviteteve trajnuese të zhvilluara gjatë një viti kalendarik, edhe rekomandimet konkrete për adresimin e problematikave te evidentuara.

Neni 5

Komunikimi mes palëve

1. Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbjnë çdo informacion të nevojshëm për përbushjen e detyrave te tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore ose në rrugë elektronike. Në çdo rast të paraqitjes së një kërkesë, palët angazhohen të japid përgjigje brenda 10 ditëve.

2. Palët angazhohen të janë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin me njëra-tjetrën me qëllim koordinimin e veprimeve që duhet të ndërmerren bashkërisht rast pas rasti.

Neni 6

Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Marrëveshje i nënshtrohen legjisacioneve në fuqi dhe janë brenda kufijve të shpenzimeve buxhetore që Palët kanë në dispozicion.

Neni 7

Kohëzgjatja e dhe ndryshimi

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një afat kohor të pacaktuar. Ai mund të ndryshojë vetëm me dakortësi të palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9

Hyrja në Fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen pranë Qandrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe dy pranë Universitetit të Prishtinës.

Nënshkruar në _____, më _____.06.2020.

QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

DREJTOR EKZEKUTIV

DIANA KASTRATI

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

REKTOR

MARJAN DEMA

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët